



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
NR...2284 REP. NR...1328 KOL.



Kontrate shitblerje kuotash te kapitalit themelues

Sot ne date 04/05/2015 (kater maj dymije e pesembedhjete), para meje Notere Alma L. Limani regjistruar prane Dhomes se Noterise Durres, me studio ligjore ne lagjen "Aqif Pasha" ne qytetin e Elbasanit, u paraqiten personalisht palet:

Pala shites: **BLENDAR HASANI**, atesia Hajdar, lindur me 01.07.1990, identifikuar me leternjoftim nr.024802326, numer personal J00701107F, me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Pala blerese: **DRITAN KOLDASHI**, atesia Emin, lindur me 07.01.1965, mbajtes i leternjoftimit nr.030206070, numer personal G50107123B, banues ne lagjen "28 Nentori" Elbasan,, me zotesi juridike per te vepruar.

ARBËR HASANI, atesia Hajdar, i datelindjes 25.09.1987, lindur ne Elbasan, identifikuar me ane te pashaportes nr.BA1171695, numer personal I70925062S, banues ne lagjen "Skenderbej" Elbasan, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Me objekt: Shitblerjen e kuotes apo 10% te kapitalit te shoqerise «Herba Fructus Natyrore» sh.p.k. :

Palet e mesiperme kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje kuote kapitali me permbajtje si me poshte vijon :

Shitesi *Bledar Hasani* zoteron 10% te kapitalit themeltar te shoqerise «Herba Fructus Natyrore» sh.p.k., e regjistruar si person juridik prane QKR me NIPT J62903374W.

Shitesi deklaroi se i shet bleresave z.*Dritan Koldashi* 5% te kapitalit qe zoteron ne shoqerine «Herba Fructus Natyrore» sh.pk. ose 4.054.500 (kater milion e pesedhjete e katermije e peseqind) leke, duke i kaluar bleresit 5% te kapitalit dhe z.*Arber Hasani*, 5% te kapitalit qe zoteron ne shoqerine «Herba Fructus Natyrore» sh.pk. ose 4.054.500 (kater milion e pesedhjete e katermije e peseqind) leke, duke i kaluar bleresit 5% te kapitalit.

Bleresat deklarojne se blejne nga shitesi *Bledar Hasani*, kuoten e kapitalit ne perqindjen dhe vleren e mesiperme, duke zoteruar keshtu *Arber Hasani* 45% te kapitalit te shoqerise, ndersa *Dritan Koldashi* 55% te kapitalit te shoqerise.

Qe nga ky moment shitesi zhvishet nga cdo e drejte personale mbi kete kuote duke ia kaluar keto te drejta bleresave, te cilet me nenshkrimin e kesaj kontrate behen pronare te shoqerise ne % e mesiperme. Pra me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi *Arber Hasani* behet pronar i shoqerise ne masen 45%, ndersa *Dritan Koldashi* behet pronar i shoqerise ne masen 55% , duke marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet perkatese. Bleresat qe nga ky moment gezojne te drejta dhe detyrime te plota pronesie mbi kete kuote kapitali. Palet deklaroi se i kane shlyer detyrimet me njeri tjetrin.

Te gjitha mosmarreshjet qe do te lindin midis paleve do te zgjidhen me mirekuptim ne te kundert ceshtja do ti drejtohet Gjykates se Rrethit Elbasan. Kontrata u hartua ne perputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi Civil nenet 705 dhe vijuesat e tij.

Kontrata u hartua ne kater egzemplare ne nje faqe me fuqi te barabarte, ku nje qendron prane kesaj zyre dhe tre te tjerat u jepen paleve, ne perputhje te nenit 51 te ligjin nr. 7829, date 1.6.1994 "Per Noterine", iu lexua paleve me ze te larte dhe te qarte, te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre, e nenshkruan ate perpara meje dhe une noterja e nenshkruaj ate sipas ligjit.

Partit kontraktuese:

SHITESI

Bledar Hosani

BLERESAT

Arbi Hapri

Dita Koldashi

NOTERE

Alma L. Limani



[Handwritten signature]